

Hapet thirrja për bursa në kuadër të Programin Erasmus + KA 2, për Projektin K-force për vitin akademik 2019-2020.

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në kuadër të programit Erasmus + KA2, për stafin me kohë të plotë të UT-së, i cili merret me manaxhimin e projektit K-Force.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

-Shkëmbimin e stafit, i cili merret me manaxhimin e projektit K-Force, për trajnim;

Universitetet në të cilat do të kryhet mobiliteti;

- Universiteti i Novi Sadit, Serbi – Mobilitet për Trajnim;

-Universiteti i Banja Lukës, Bosnje-Hercegovinë – Mobilitet për Trajnim;

Kohëzgjatja e bursave:

-5 ditë + 2 ditë udhëtimi.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj B2 (Anglisht);
- Letër Suporti nga Koordinatorin e Projektit;
- Plani i mobilitetit për Trajnim;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për trajnim klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Mobility_Agreement_Training_outgoing.docx

*Plani i Mobilitetit për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së mobilitetit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatorin Institucional i Erasmus +.

Afati për aplikim: 5 Shkurt 2020

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë nga e Hëna në të Enjte ora 10:30 – 11:30 dhe 14:30 – 16:00, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!